



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUJË
NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr _____ Prot

Kruje, 26.03.2019

Shtojca 14

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: ["KASTRATI" sh.p.k Durres Durres DURRES Lagja 14, Rruga Tirana, Prane Gjykares se Apelit, Shkozet/

Procedura e prokurimit: E Hapur.

Numri i referencës së procedurës: REF-09196-02-19-2019

Numri i referencës së lotit II-të : REF-09204-02-19-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Loti i II-të : "Blerje karburanti (benzine Premium Unl 10 ppm) per Bashkine Kruje ".

Fondi limit kontrates/lotit: 82,178 (tetedhete e dy mije e njeqind e shtatedhete e tete) lekë pa t.v.sh

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**

Në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, **çmimi më i ulët** bazohet në:

i) çmimi i bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili është publikuar në

Buletinin e fundit të Njoftimeve Publike, para datës së dorëzimit dhe hapjes së ofertave;
ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
iii) marzhi më i ulët i fitimit, të shprehur në përqindje.

Vlera absolute e marzhit të fitimit nuk do të ndryshojë gjatë ekzekutimit të kontratës, në rast të luhatjes së çmimeve.

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“KASTRATI ” sh.p.k** , me adrese Durres, Lagjia14, Rruga Tirana, prane Gjykates se Apelit Shkozet , me NIPT J61813529P , me administrator Shefit Kastrati.

Vlera e ofruar eshte : Marzhi i fitimit 15,4%(pesembedhjete pike kater), e shprehur ne perqindje.

2. **EUROPETROL DURRES ALBANIA** me adrese Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 2, Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 5, Shkalla 1, Apartamenti 1 me NIPT K24010212N me administrator Frident Kuqi

Vlera e ofruar eshte : Marzhi i fitimit : 6.75 % (gjashte pike shtatedhjete e pese), e shprehur ne perqindje.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **EUROPETROL DURRES ALBANIA** me adrese Tirane Tirane TIRANE Njesia Nr. 2, Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 5, Shkalla 1, Apartamenti 1 me NIPT K24010212N me administrator Frident Kuqi .Vlera e ofruar eshte : Marzhi i fitimit : 6.75 % e shprehur ne perqindje.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

-Subjekti ne kundërshtim me piken 2.3.2/b te dokumentave standarte te tenderit ku kerkohet flete analiza e leshuar nga ISHTI, qe verteton cilesine e produktit objekt te kesaj kontrate gasoil 10 ppm, qe ofertuesi tregton sipas standarteve te percaktuara, S.SH.EN 590-2013, A1/2017 ne pajtueshmeri me specifikimet teknike te leshuar jo me pare se 6 muaj nga data e hapjes se ofertave, ka paraqitur flete analizen e subjektit “Kastrati” sh.a, i cili tregeton karburante me shumice por nuk mund te merret ne konsiderate pasi autoritetit kontraktor bashkia Kruje i intereson cilesia e karburantit te tregtuar nga subjekti Europetrol Durres Albania ne pikat e saj fundore dhe kryesisht ne pikat e tregtimit ne territorin e bashkise Kruje. Fleteanaliza e paraqitur ne kete rast nuk eshte “raport analize per tregun e brendshem” ku monstat merren ne pikat e tregtimit me pakice te ofertuesit por eshte “raport analizimi para zhdoganimit” e cila demonstroi cilesine e naftes se importuar nga grosisti (ne kete rast “Kastrati” sha) dhe monstat jane marre nga anija cisterne perkatese. Persa me siper kjo flete

analize nuk e permbush qellimin e kerkesave te autoritetit kontraktor bashkia Kruje pasi nuk e ben te verifikueshem cilesine e karburantit te tregetuar nga ofertuesi pjesemarres ne tender.

-Ofertuesi ne kundershtim me piken 4 te dokumentave standarte te tenderit nuk ka paraqitur asnje dokument pronesie shoqeruar me hartën treguese hipotekore per te provuar disponimin e te pakten dy stacioneve te tregtimit me pakice te karburanteve te instaluara respektivisht secila ne territorin administrative te zonave urbane te bashkise Kruje ne pronesi ose me qira. Gjithashtu subjekti ofertues, nuk ka paraqitur licensat per dy stacionet e tregtimit te karburantit te leshuara nga njesia e qeverisjes vendore sipas kerkesave te VKM-se Nr. 970, date 01.12.2015 i ndryshuar si nje nga kushtet e kerkuara per te provuar disponimin e ketyre dy pikave te tregtimit.

- Ne piken 7 te dokumentave standarte te tenderit eshte kerkuar qe bazuar ne VKM-ne me Nr. 561, date 29.07.2016 “ Per standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit me njesite e qeverisjes se pergjithshme”, operoret ekonomike pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve(Webpage), me qellim administrimin e furnizimit elektronik te Krtave elektronike perkatese te mjeteve. Per te provuar kete ofertuesit duhet te paraqesin te dhenat elektronike te faqe web zyrtare te shoqeruar me manualin perkates te perdorimit te programit perkates te furnizimit me karburant. Ne kundershtim me kete kerkese te DST-se subjekti nuk ka paraqitur manualin e perdorimit programit perkates te furnizimit me karburant.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se [“Kastrati“ sh.p.k, Durrës, Lagjia 14, Rruga Tirana, prane Gjykates se Apelit Shkozet me nr NIPT-i J61813529P dhe , me administrator Z Shefit Kastrati] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme, marzhi i fitimit i shprehur ne perqindje prej [15.4% (pesembedjete pike kater)] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkise Kruje Qender Sheshi Mustafa Merlika (Kruja)] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [nuk ka operatore ekonomik te tjere te klasifikuar], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **18.03.2018**

Ankesa: ka ose jo [JO]

Brenda afateve ligjore te parashikuara ne Ligjin nr 9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar , nuk është paraqitur asnjë ankesë.

Titullari i Autoritetit Kontraktor

ARTUR BUSHI



Konceptoi;G.Halili
Nr ekzemplareve:2k
Datë:...../...../2019